



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2024/0736**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga, Isa Hasani-kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) " Bletaria Te Ahmeti " SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Komuna e Gjilanit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me shoqeri bletesh" me numër të prokurimit; 651-24-570-1-2-1, me 15/10/2024, mori:

### **Vendim**

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE " Bletaria Te Ahmeti " SH.P.K. me nr. 2024/0736 , e datës 14/08/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit mr titull "Furnizim me shoqëri bletësh" me numër të prokurimit; 651-24-570-1-2-1, AK- Komuna e Gjilanit

2.Mbetet në fuqi vendimi i autoritetit kontraktues, i datës, 01.08.2024, AK- Komuna e Gjilanit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me shoqëri bletësh" me numër të prokurimit; 651-24-570-1-2-1.

2. Lejohet kthimi i tarifës për ankesë, në vlerën e deponuar për paraqitjen e ankesës, Operatorit ekonomik " Bletaria Te Ahmeti " SH.P.K, sipas nenit 31.4. OE obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për tërheqje të depozitës për sigurim të ankesës, në të kundërtën bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **Arsyetim**

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me01.02.2024,Komuna e Gjilanit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit.

Ndërsa me datën 15.03.2024 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë “NTP Bletaria Egzoni " SH.P.K ”.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim me vlerë të parashikuar të kontratës 24,000.00 €

Me 20.03.2024, OE " Bletaria Te Ahmeti " SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 22.03.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 09.03.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE " Bletaria Te Ahmeti " SH.P.K. me numër protokolli 2024/0736 lidhur me aktivitetin e prokurimitFurnizim me shoqëri bletësh me numër të prokurimit 651-24-570-1-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues " Bletaria Te Ahmeti " SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) : “AK-ja ne Sqarime ne pyetjet e dërguara nga OE -Furnizim me shoqëri bletësh te datës 13.02.2024. Shume kjarte citon ne përgjigjet e veta tek përgjigjja e pare si me poshtë ku po e vendosim për ta pare : Shikojeni përgjigjen tuaj ku e keni cituar mjaftë kjarte qe se bashku me ofertën duhet te dorëzohet Deklarata e nënshkruar dhe vulosur nga OE ne te cilën deklarohet se i ka lexuar dhe kuptuar mire specifikat – Ne këtë gjë e kemi bere ku kemi ofruar deklaraten qe i përmbushim gjitha specifikat teknike konform kërkesës se AK-se ne gjitha specifikat teknike sipas aneksit 1 te dosjes se tenderit. Andaj AK-ja ne vendimin e datës 01.08.2024 ka gabuar ne vendimin për eliminim te kompanisë sonë ne vendim jo te drejt jo profesional dhe një vendim skandaloz duke mos shikuar përgjigjet e tyre te dhëna me date 13.02.2024 kjo është vetëm njëra nga gabimet ne vendim te AK-se e cila nuk është dashur te ndodhte..”

Pretendimi i dytë (II) : “ Gabimi i dyte i AK-se është se nuk ka lexuar dhe kuptuar si duhet interpretimin dhe përgjigjen nga eksperti shqyrtues ku ka cituar si me poshtë : Shikojeni me larte se çka ka kërkuar eksperti shqyrtues nga ju si AK , gjë te cilën nuk e keni bere nuk e keni marre këtë rekomandim te ekspertit ku ka kërkuar nga ju ne baze te nenit 72 dhe nenit 38 te rregullores qe gjate rivlerësimit te ofertave te sqarohet lloji i ofruar i bletëve , këtë gjë ju nuk e keni bere sepse nuk keni dërguar tek ne sqarim ne lidhje me këtë , dhe për këtë gjë ju keni shkelur ligjin nenin 72 dhe 38 te rregullores dhe rekomandimin e ekspertit. Keni bere vendim te ngutshëm

aspak profesional aspak ne harmoni me LPP-ne , por vendim te pa bazuar krejt kjo ka rrjedhe nga një jo profesionalizëm i juaj duke mos aplikuar rekomandimin e ekspertit dhe duke mos analizuar dhe lexuar ne tërësi raportin .”

Pretendimi i tretë (III): “Gabimi i tret i AK-se është sipas Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë Shume kjarte ne Ligjin e Prokurimit Publik citohet te ky nen si me poshtë: Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji. AK-ja ne rastin tone nuk ka përfillur këtë nen duke mos na ftuar ne si OE për te plotësuar apo ne rastin tone te qartësojmë llojin , kjo është shkelje nga AK-ja sepse nuk ka vepruar si duhet ne vlerësim , ka bere vlerësim te gabuar jo te drejte duke mos vlerësuar sipas kushteve dhe neneve te LPP-se.”

Pretendimi i katërt : “ Gabimi i katert i AK-se eshte RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK - Neni 38 Sqarimi i Tenderëve pika 38.1 , 38.3 , 38.4 , 38.5 , 38.6 38.1 Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, AK mund të kërkoj nga secili tenderues individualisht për sqarim të tenderit të tij/saj. KRPP ka aprovuar një formular standard B47 për sqarime për të përdorur nga AK “Kërkesë për sqarim të tenderit”. Kërkesa për sqarim dhe përgjigja duhet të bëhet përmes platformës elektronike. AK nuk e ka bere këtë. 38.3 Megjithatë, lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyre objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës se publikimit të Njoftimit për kontrate. 38.4 Autoriteti kontraktues do të sigurojë mundësinë e sigurimit të informacionit shtesë në kushte të njëjta për të gjithë Operatorët ekonomik dhe do të kërkojë informacion nga Operatorët ekonomik me qëllim të qartësimin të përmbajtjes së deklaratave të paqarta, certifikatave të përfshira në tenderë apo kërkesave për pjesëmarrje. Sqarimi dhe kërkesa për informacion shtesë, informacion plotësues dhe dokumente është pjesë e procedurës së vlerësimit. Kërkesa kalon / nuk kalon dhe vlefshmëria e ofertave/aplikacioneve mund të vendoset vetëm pas dorëzimit të përgjigjeve në pyetjet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues dhe pas shqyrtimit të dokumenteve shtesë të paraqitura. 38.5 Autoriteti kontraktues mund të ftojë Operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojnë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të LPP-se d.m.th dëshmitë e dorëzuara për kërkesat e përshtatshmërisë, kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, gjendjes ekonomike dhe financiare dhe aftësisë teknike dhe profesionale, certifikatat e kualitetit, kërkesat e grupeve të OE. 38.6 AK do të caktoj afat kohor të arsyeshëm për OE për sqarim të tenderit të tyre. Bazuar ne përshkrimin e bërë me sipër sipas LPP-se dhe neneve ne fuqi dhe rregullores ne fuqi vijmë ne përfundim se AK-ja ka bere vlerësim te gabuar te këtij aktiviteti duke mos përfillura si duhet Rekomandimin e Ekspertit dhe duke mos përfillur Nenin 72 dhe neni 38 te rregullores ku mjaftë kjarte i kemi shtjelluar me larte. Ky vendim i AK-së vjen ne një vendim jo profesional te ngutur dhe tendencioz duke na eliminuar neve si kompani e cila kemi gene e përgjegjshme me çmimin me te ulet te ofruar ne krahasim me OE te tjerë dhe fitues sipas vendimit te AK-se te datës 15.03.2024. Nga kronologjia e bërë ankesës sonë i kemi prezantuar me fakte dhe detaje 4 gabimet qe AK-ja ka bere ne vlerësimin dhe krahasimin se si duhet te bere

këtij aktiviteti.”

Duke u referuar kërkesave si më sipër OE " Bletaria Te Ahmeti " SH.P.K, konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me neni 1, 6, 7, 52, 59, 60, 72 të LPP-së dhe Neni 38.1, 3, 4, 5, 6 të Rrpp-së. Bazuar ne përshkrimin e bërë me sipër, sipas shkresave të lëndës, dosjes së tenderit, raportit të rivlerësimit, dosjes së tenderit, pretendimeve ankimore të ankuesit, eksperti shqyrtues rekomandon panelin shqyrtues të Anulohet Vendimi i AK-së i datës 01.08.2024 mbi dhënie e kontratës dhe ankesa e operatorit ekonomik ankues të konsiderohet pjesërisht e Bazuar, dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Përgjigje e AK në kërkesën për rishqyrtim:

” OE “ Bletaria te Ahmeti Sh.P.K” si palë e pakënaqur me datën 05.08.2024 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtimi kundër Njoftimi mbi Vendimin e AK e dt. 01.08.2024 të publikuar në platformën e prokurimit elektronik, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titullin “ “ Furnizim me shoqëri bletësh “ me nr. identifikues GL 651 24 570 121 dhe me numër të brendshëni tëprokurimit: GL 651 24 021121 521. Autoriteti Kontraktues -Kuvendi Komunal Gjilan konstaton se Kërkesa për rishqyrtim e OE ankuese është ushtruar brenda afatit ligjor në pajtim me nenin 108/A paragrafi 3.1 të LPP sipas procedurës paraprake për zgjedhjen e mosmarrëveshjeve dhe si e tillë i përmban elementet e përcaktuar me nenin 60 paragrafin 3 t% Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik .Në këtë mënyrë Zyrtari Përgjegjës i prokurimi të AK -Komuna e Gjilanit ka konstatuar se është kompetent për shqyrtuar këtë kërkesë sipas nenit 108/A të LPP -së dhe se nuk ekziston asnjë pagesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore . Në këtë pikëpamje Zyrtari Përgjegjës i prokurimit të AK -së , me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike në mënyrë objektive dhe ligjore ka shqyrtuar dhe analizuar në detaj tërësinë e secilit pretendim ankimor në kontekstin e atakimit nga OE ankues dhe në këtë mënyrë është gjetur se : Pretendimet e OE ankuese “Bletaria te Ahmeti Sh.P.K” janë të pa bazuar sepse Njoftimi mbi Vendimin e AK është i drejt dhe rrjedhimisht i ligjshëm në pajtimin me të gjitha dispozitat përkatëse të LPP-së dhe të legjislacionit sekondar të prokurimit publik. Konstatimet e AK-Së Bazuar në faktet dhe rrethanat e rastit. Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye :Komisioni për ekzaminintin, RT -vlerësimit dhe krahasimin e tenderëve ka konstatuar këtë procedurë të prokurimit si dhe bazuar në Vendimin e OSIIP-së 2024/0276 ku është konstatuarës një kërkesë e tillë në formë e kërkesë dhe dështim nuk është kërkuar tek kriteret e përzgjedhjes mirëpo vetëm tek pyetje sqaruese e datës 13.02.2024 ku , autoriteti kontraktues —se bashku me njësinë kërkesës tek pyetjes për sqarim e ka specifikuar llojin e bletëve që duhet të Ofertuar tek pyetja nr. 15. Raca e bletëve a duhet të jetë ApisMillfera apo race tjetër, Raca e kërkuar e bletëve duhet të jete .:Apis mellifica var. camica Pollm ku OE "Bletaria te Ahmeti Sh.P.K k ateo ertimi nuk ka deklarate nënshkruar dhe vulosur për oferimin e llojit të Bletëve sipas kërkesës së pyetjes sqaruese (pyetja nr. 15) të dt. 13,02.2024. Lidhur me pohimet e secilit pretendim ankimor të OE Ankuese “Bletaria te Ahmeti Sh.P.K” në baze të fakteve , proave dhe dokumentet relevante të Autoritetit Kontraktues nga njëra anë dhe bazë ligjore të zbatueshme me rastin konkret nga ana tjetër, AK-Komuna e Gjilanit ka vlerësuar si në vijim : Pretendimet ankimore të lartë cekura janë të pabazuara pasi që komisioni i vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve është bazuar në Vendimin e OSHP-së 2024/0276, ku OE i rekomanduar me kontratë rreth Deklaratës të specifikuar për racën e bletëve ka ofruar deklaratë me shkrim. Bazuar në të lart ceku, AK konsideron se në të gjitha veprimet dhe aktet e AK-se, gjate këtij procesi të prokurimit se ka vepruar në pajtueshmëri të plote me të gjitha dispozitat përkatëse

ligjore te LPP-së dhe legjislacionit sekondar Rregullores së prokurimit publike cilat parashohin dhe rregullojnë kushtet dhe kriteret që paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit. ”

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 15/08/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0736/2024, ndërsa me datë 28/08/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0736 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim. Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është Pajtuar lidhur me rekomandimin e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk është Përgjigjur lidhur me mendimin e ekspertit .

Lidhur me pretendimet e OE " Bletaria Te Ahmeti " SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0736 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i pare (I): “Sqarojmë se kemi te bëjmë vetëm me një pretendim ankimor qe ka te bëjë me ofrimin e llojit te caktuar te bletëve. Në raportin e ekspertit nr. 2024/0276 te datës 07.04.2024 kemi konstatuar si ne vijim: “Eksperti shqyrtues konstaton se një kërkesë e tillë ne formën e kërkesës dhe dëshmisë nuk është kërkuar te kriteret e përzgjedhjes mirëpo vetëm tek pyetjet sqaruese te datës 13.02.2024, ku AK-KK Gjilan ka specifikuar llojin e bletëve qe duhet ofertuar. AK-KK Gjilan gjatë procedurës se vlerësimit sipas nenit 72 te LPP-së dhe nenit 38 te Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik është dashur te sqaroj me operatorin ekonomik te rekomanduar për kontratë nëse ky operator ekonomik ka ofruar llojin e bletëve sipas kërkesës se pyetjeve sqaruese (pyetja nr.15) te dt.13.02.2024.” Rekomandojmë qe një sqarim i tillë sipas nenit 72 te LPP-së dhe nenit 38 te Rregullores për Prokurim Publik , AK-KK GJILAN te i bëjë gjatë procedurës se rivlerësimit te ofertave dhe te sqarohet lloji i ofruar i bletëve sepse nuk mund te shpërblehet një operator ekonomik me kontratë pa përcaktuar llojin e ofruar te furnizimeve. Bazuar ne përshkrimin e mësipërm, pyetjeve sqaruese, dosjen e tenderit dhe shkresave te lendes konstatojmë se ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar. Eksperti shqyrtues sqaron se AK-KK VITI gjatë procedurës se rivlerësimit nuk ka kërkuar sqarimet shtesë sipas nenit 72 te LPP-se dhe nenit 38 te RrPP 001/2022 ne lidhje me ketë pikë mirëpo ne raportin e rivlerësimit te datës 01.08.2024 ka shpërblyer me kontratë operatorin ankues NTP Bletaria Egzoni sipas , pra nuk ka kërkuar sqarimet shtesë ne fazën e rivlerësimit sipas raportit te ekspertit dhe vendimit te OSHP-së nr. 2024/0276 te datës 20.06.2024. Andaj bazuar ne sqarimet e dhëna ne raportin nr. 2024/0276 (te përshkruara edhe mësipërm) , po ashtu sipas Vendimit te OSHP-se nr. 2024/0276 rekomandojmë qe AK-KK VITI ne procedurën e Rivlerësimit duhet te ju përmbahet në tërësi rekomandimeve te dala nga vendimet e OSHP-së. Kthimin e lëndës në RIVLERËSIM e mbështesim ne faktin se OE Bletaria Ahmeti , operator ankues ne ketë rast ka dorëzuar ofertën si operator i parë nga te dy ofertuesit qe kanë çmime te njëjta dhe sipas nenit 39.8 i cili thotë “Në rastet kur Autoriteti Kontraktues pranon 2 (dy) apo me shumë oferta të përgjegjshme me çmime

të njëjta (identike) nuk vlen votimi i anëtareve të Komisionit të vlerësimit për përzgjedhjen e OE, por përzgjedhja bëhet sipas kohës së dorëzimit të ofertës (OE i cili e ka dorëzuar ofertën i pari)". Bazuar në përshkrimin e bërë me sipër, sipas shkresave të lëndës, dosjes së tenderit, raportit të rivlerësimit, dosjes së tenderit, pretendimeve ankimore të ankuesit, eksperti shqyrtues rekomandon panelin shqyrtues të anulohet Vendimi i AK-së i datës 01.08.2024 mbi dhënie e kontratës dhe ankesa e operatorit ekonomik ankues të konsiderohet pjesërisht e Bazuar, dhe lënda të kthehet në Rivlerësim..”

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtrësia e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues vlerëson se raporti i ekspertizës i përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit.

Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, ka administruar si prova: Raportin e Ekspertit Shqyrtues nr.0736/24, dt.28.08.2024, ankesa e Operatorit Ekonomik "Bletaria Te Ahmeti" Njoftimin për Kontratë, i datës 01.02.2024, Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, i datës 01.08.2024, për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me shoqëri bletësh" me numër të prokurimit; 651-24-570-1-2-1, Vendim i Autoritetit kontraktues për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, i datës, 07.08.24 dhe vendimi OSHP-së nr. 2024/0276 të datës 20.06.2024.

Paneli shqyrtues vëren se lidhur me këtë aktiviteti të prokurimit "Furnizim me shoqëri bletësh" me numër të prokurimit; 651-24-570-1-2-1, iniciuar nga AK-Komuna Gjilan, OSHP e ka marrë vendim me numër 2024/0276, lidhur me të njëjtin aktivitet, raste të përsëritur, pretendimet e njeta palët e njeta ankuese dhe objekti i kontestit i njëjtë.

Paneli shqyrtues vëren se me vendimin 2024/0276 të datës 20.06.2024, ankesa në operatorin ekonomik OE " Bletaria Te Ahmeti " është aprovuar dhe lënda është kthyer në rivlerësim tek autoriteti kontraktues Komuna Gjilan. Nga provat e lartshënuara konstatohet se Autoriteti kontraktues Komuna Gjilan e ka zbatuar vendimin e panelit duke e rivlerësuar edhe njëherë

aktivitetin e prokurimit dhe ka nxjerr vendimin e rivlerësimit me datën 01.08.2024. OE ankues i pakënaqur me vendimin e rivlerësimit të AK-se, OE ankues ka paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim të AK, e cila me vendimin e saj të datës 07.08.2024 e refuzon ankesën si të pabazuar dhe e vërteton njoftimin mbi vendimin e AK-se të datës 01.08.2024.

Paneli shqyrtues konstaton se Autoriteti Kontraktues Komuna Gjilan, me vendim të datës 07.08.2024, i ka dhënë përgjigjeje OE ankues duke e argumentuar refuzimin e pretendimeve ankimore ankuese, të cilat janë bindëse edhe për vete Panelin shqyrtues, të cilit dhe i fale besimin e provës në marrjen e vendimit. Autoriteti i kontraktues palën ankuese OE” Bletaria Te Ahmeti " ofertën e tij e ka konstatuar shpallur si të papërgjegjshme me arsyetimin si në vijim: *“Komisioni për rivlerësim dhe krahasim të tenderëve ka konstatuar në këtë procedurë të prokurimit sit e bazuar në vendimin e OSHP-se 2024/0276, ku është konstatuar se një kërkesë e tillë në formë të kërkesës dhe dëshmisë nuk është kërkuar tek kriteret e përzgjedhjes mirëpo vetëm të pyetjet sqaruese e datës 13.02.2024, ku autoriteti kontraktues se bashku me njësinë kërkuese tek pyetjes sqarim e ka specifikuar llojin e llojin e bletëve që duhet ofertuar pyetja 15, Raca e bletëve a duhet të jete ApisMillfera, apo race tjetër. OE “Bletaria te Ahmeti” për këtë emërtim të bletës nuk e ka sjelle deklaratën e nënshkruar dhe të vulosur për ofertim të llojit të bletës, sipas kërkesës së pyetjes sqaruese(pyetja nr.15) e dt.13.02.2024. Rrjedhimet, Komisioni Profesional Ekzaminimit dhe Vlerësimin e e ofertave ka konstatuar se oferta e juaj është e Papërgjegjshme”*

Po ashtu Paneli shqyrtues po ashtu vëren se AK-në gjatë procedurave të vlerësimit ka aplikuar qartë dispozitatë nenit 72 të LPP-së dhe të nenit 38 të Rregullores së Prokurimit Publik, i cili lejon sqarimet pyetjet dhe plotësimin e dokumentacionit citojmë: Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës, në këtë rast paneli vëren se OE ankues në këtë rast nuk e ka plotësuar ofertën e tij me dokumente sipas pyetjes 15 të paraqitur.

Paneli shqyrtues konstaton se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitatë ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit, sqarimet, lidhur me aktivitetin e prokurimit, andaj Paneli përfundimisht ka vendosur për të refuzuar ankesën e Operatorit ekonomik” Bletaria Te Ahmeti " dhe mbetet në fuqi “Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues” datës, 01.08.2024, Komuna Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me shoqëri bletësh" me numër të prokurimit; 651-24-570-1-2-1, iniciuar nga AK-Komuna Gjilan.

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të pjeserishëm të ankese të OE” Bletaria Te Ahmeti " , vendosi të kthehet tarifa e ankës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Andaj, Paneli Shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional konform nenit 59 par. 1 të LPP-së, ku thote: “Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës”, atëherë në zbatim të nenit 1 të LPP-së dhe me qëllim që mos ta prolongohet ky aktivitet i prokurimit edhe më tutje. Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në

planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendosë po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi





Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Isa Hasani**

*Hasani*

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**
- **OE - " Bletaria Te Ahmeti " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: